

URDHËR
Nr. 399, datë 26.11.2020

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT DISIPLINOR TË
PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të shkronjës “b”, të pikës 1 dhe të pikës 2, të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”; si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”,

KONSTATOJ:

Në zbatim të kërkesës së shprehjes së interesit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, nr. 6547, datë 19.10.2020, janë paraqitur kandidaturat të cilat kanë shprehur interes në lidhje me Komisionin Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, në referim të pikës 1, të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, ku 1 anëtar zgjidhet nga ministri i Drejtësisë.

Në zbatim të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 368, datë 6.11.2020, “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, është vijuar me trajtimin e kandidaturave të paraqitura dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

Kandidati z. Erind Merkuri ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, brenda afatit ligjor të përcaktuar në shprehjen e interesit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Sipas dokumentacionit të përcjellë rezulton, se z. Merkuri ka marrë gradën shkencore “Doktor”, me nr. 1351, datë 9.5.2016, të lëshuar nga Universiteti i Tiranës, në fushën “Aspekte procedurale të gjyqimit kushtetues”.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 87, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: *“Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën e lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar”*, u zhvillua një seancë dëgjimore në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë më datë 24.11.2020.

Duke qenë se në përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Disiplinor kanë përparësi kandidatët që zotërojnë titull ose gradë shkencore, eksperiencë profesionale shkencore në çështjet e së drejtës civile, si dhe duke marrë shkas nga përvoja si avokat pranë Shoqërisë “Meksi Law and Consulting”, është vlerësuar kualifikimi i kandidaturës së z. Erind Merkuri.

Sa më sipër, në kushtet kur z. Erind Merkuri përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Zgjedhjen e z. Erind Merkuri si anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.
2. Mandati si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, fillon në datë 1.12.2020 dhe përfundon më datën 30.11.2024.
3. Ngarkohet z. Erind Merkuri, që brenda 10 ditëve nga zgjedhja e anëtarëve të Komisionit, të thërrasë mbledhjen e parë të Komisionit.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij urdhri, z. Erind Merkuri, Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.
5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)